

Roli i Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit

Ministri i Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit bashkërendon punën për hartimin e politikave dhe përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.

Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit është përgjegjës për kryerjen e verifikimit (hetimit administrativ) të denoncimeve/ankesave për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare për zbatimin e ligjshmërisë, si dhe identifikimi i punonjësve të institucioneve, pjesë të Rrjetit të Koordinatorëve, të cilët, me veprime apo mosveprime, kanë kryer shkelje të akteve ligjore/nënligjore në fuqi, si dhe njëkohësisht zhvillimi i projekteve dhe i programeve në fushën kundër korrupsionit, planifikimi, koordinimi dhe përcaktimi i instrumenteve të domosdoshme për implementimin e politikave të fushës kundër korrupsionit.

Buletini elektronik është një mjet i gjerë komunikimi që synon të informojë nëpërmjet pasqyrit të një përmbledhjeje të aktiviteteve kryesore të zhvilluara nga Ministria e Drejtësisë në fushën antikorrupsion, mbi baza mujore.

Aktivitetet përgjatë muajit Tetor, 2022

Ministria e Drejtësisë gati për takimin bilateral me Komisionin Evropian, kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore

01-28.10.2022: Në datat 27 dhe 28 tetor 2022 u krye ushtrimi simulues për prezantimin e Qeverisë shqiptare, në kuadër të kapitullit 23: "Gjyqësori dhe të drejtat themelore". Informacioni konkret dhe i përshtatshëm për të siguruar një raportim të plotë, përfshirës dhe efektiv të veprimtarisë që përfshin ky kapitull është punuar në një dokument prezantimi dhe do të paraqitet në nëntor para ekipit të ekspertëve të Komisionit Evropian. Pjesëmarrës në zhvillimin e këtij ushtrimi ishin të gjithë përfaqësuesit e institucioneve kontribuese përgjegjëse për përgatitjen e këtij informacioni. Antikorrupsioni është një prej komponentëve të këtij kapitulli dhe do të ofrojë të dhëna të hollësishme mbi politikën antikorrupsion, kuadrin ligjor dhe institucional, organizimin strukturor dhe instrumente të luftës kundër korrupsionit në vend. Prezantimi përfshin edhe informacione specifike të autoriteteve të tjera të angazhuara në luftën kundër korrupsionit në vend si: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Struktura e Specializuar Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Byroja Kombëtare e Hetimit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. I gjithë procesi është kryer në bashkëpunim me projektin SEI, i cili ka asistuar Ministrinë e Drejtësisë në mbledhjen, përpunimin dhe paraqitjen e të dhënave. Prezantimi final do të bëhet në datat 24 dhe 25 nëntor 2022, në Bruksel, me zhvillimin e takimeve bilaterale, nën drejtimin e negociatores për kapitullin 23, zëvendësministren Adea Pirdeni.



Finalizohet raporti 6-mujor 2022, i monitorimit të Planit të Veprimit Antikorrupsion

04.10.2022: Ministria e Drejtësisë ka finalizuar raportin e monitorimit, janar - qershor 2022, për zbatimin e Planit të Veprimit Antikorrupsion. Në takimin e Grupit teknik Tematik Antikorrupsion datës 4.10.2022, u diskutua dhe u dakordësua raporti final i monitorimit për zbatimin e planit të veprimit antikorrupsion, janar-qershor 2022. Të gjithë institucionet zbatuese të planit të veprimit, ranë dakord për të dhënat e përfshira në këtë raport dhe analizën e tij. Sipas këtij raporti monitorimi, zbatimi i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit për këtë periudhë është 69.01% dhe sipas qasjeve, përkatësisht: 84.99 për qasjen parandaluese A; 41.5% për qasjen ndëshkuese B dhe 75% për qasjen ndërgjegjësuuese C. Për këtë periudhë monitorimi janë vlerësuar 56 masa e 103 aktivitete të parashikuara për zbatim, si dhe 37 treguesit e performances, të cilët japin një trend të rëndësishëm në kuadër të matjes së tyre. Ky raport monitorimi do të miratohet në takimin e Grupit Tematik Antikorrupsion, të udhëhequr nga Ministri i Drejtësisë, në nëntor 2022.

Vijojnë konsultimet teknike institucionale për strategjinë antikorrupsion 2023-2030

17-27.10.2022: Kanë vijuar përgjatë muajit tetor 2022, takime teknike të punës dhe konsultimi me institucionet i draft dokumentit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2023-2030, dhe të Planit të Veprimit. Janë zhvilluar takime të posaçme me 21 institucione me qëllim që të dakordësohen të gjithë elementët përbërës (indikatore dhe masa) të dokumentit. Shtimi i kapaciteteve të përshtatshme në të gjitha nivelet për menaxhimin e politikave të integritetit, rritja e kontributit të sinjalizimit si një mjet për ndërtimin e integritetit, forcimi i mekanizmave për zbatimin e vlerësimit periodik të kornizës kundër korrupsionit dhe fuqizimi i përgjithshëm i kapaciteteve për menaxhimin e njohurive, janë disa nga objektivet e sjella si produkt i dakordësuar i këtyre tryezave të përbashkëta. Ministria e Drejtësisë në Rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit vijon të asistohet në këtë proces ngushtësisht nga Projekti i Asistencës Teknike për Antikorrupsionin i Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri. Së shpejti, Ministria e Drejtësisë do të nisë procesin e konsultimit publik të draft dokumentit, me grupe interesi që operojnë në fusha të ndryshme, OSHC, biznese, partnerë ndërkombëtarë.




Drejtorja e Përgjithshme e Antikorrupsionit jep masa për raste të gjetura në shkelje të ligjit

1-31.10.2022: Drejtorja e Përgjithshme e Antikorrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë, ka zhvilluar një sërë hetimesh administrative pranë institucioneve të ndryshme, pjesë të Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion. Hetimet dhe verifikimet janë kryer kryesisht si dhe të iniciuar nga ankesat dhe denoncimet e ardhura pranë drejtorisë nga burime të ndryshme. Në përfundim të hetimeve administrative të zhvilluara, janë propozuar raporte përfundimtare propozime të masave administrative ndaj nëpunësve/punonjësve të këtyre institucioneve. Konkretisht, në muajin tetor 2022, është proceduar me raport përfundimtar hetimi administrativ për Autoritetin Kombëtar të Ushqimit dhe Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, për të cilët janë evidentuar personat përgjegjës të gjetur në shkelje, si dhe janë lënë rekomandime për institucionin me qëllim ndërmarrjen e masave përkatëse, jo vetëm në respektim të zbatimit të ligjit por dhe përmirësimit të veprimtarisë së punës të këtyre institucioneve. Aktualisht, Rrjeti i Koordinatorëve Kundër Korrupsionit, po vijon punën me hetimin e rasteve të denoncuar, me qëllim intensifikimin e luftës kundër korrupsionit, pranë të gjitha institucioneve pjesë të këtij Rrjeti, me synimin për ti kthyer qytetarëve të drejtat e mohuara, rritur integritetin e organeve publike, dhe forcimin e zbatueshmërisë së ligjit, për një "Shqipëri të fortë dhe të së drejtës".

Udhëzuesi antikorrupsion, një iniciativë e përbashkët rajonale

11-13.11.2022: Lufta kundër korrupsionit mbetet në vëmendje të shtuar në vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor, përkatësisht Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Kosova dhe Serbia. Iniciativa e mbështetur nga UNODC, Udhëzuesi "Antikorrupsioni dhe Financimet e Paligjshme (Roadmap)", mblodhi bashkë përfaqësues të autoriteteve ekzekutive, politikëbërës dhe agjenci ligjzbatuese të vendeve të Ballkanit, në Dubrovnik, Kroaci, për të ndarë eksperiencat e zbatimit një-vjeçar të këtij dokumenti, si një mënyrë e mirë bashkëpunimi për të bashkërenduar veprimet. Prokurimet publike, deklarimi i aseteve dhe interesave private dhe bashkëpunimi ndërmjet organeve ligjzbatuese në luftën kundër korrupsionit janë objektiva për zbatim të këtij udhëzuesi, të iniciuar në takimin politik të Samitit të Berlinit në vitin 2018 dhe të materializuar në një dokument teknik, me mbështetjen e UNODC, në qershor 2021. Vendet ndanë të dhënat e tyre dhe informacionet për kuadrin rregullator dhe institucionin të fushës së prokurimeve publike, informacione mbi deklarin dhe platformën online të deklarimit të pasurive dhe interesave private, dhe informacione mbi veprimtarinë dhe të dhëna të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), të Policisë së Shtetit, të njësive së Pastrimit të Parave. Udhëzuesi do të rishikohet në një takim teknik të muajit nëntor, për tu finalizuar dhe dakordësuar me vullnetin politik të krerëve të qeverive të vendeve në konferencën rajonale antikorrupsion në Shkup, në 9 dhjetor 2022.



Trajnohen ekspertët e administratës publike që do të asistojnë institucionet për planet e integritetit

25-26.10.2022: Ngrihet grupi i parë i trajnerëve, punonjës të organeve të administratës publike, që do të informojnë dhe asistojnë institucionet publike në vlerësimin e riskut të integritetit dhe hartimin e Planeve të Integritetit. Organizata IDM Albania së bashku me ASPA-n, zhvilluan në datat 25 e 26 tetor 2022, një takim-trajnim për një grup punonjësish të institucioneve publike me qëllim përgatitjen e tyre për të aplikuar hartimin dhe zbatimin e instrumenteve të antikorrupsionit siç janë planet e





integritetit. Kjo iniciativë vjen në kuadër të projektit "Forcimi i integritetit për përmirësimin e shërbimeve publike". Ekspertë pranë IDM Albania ndanë kurrikulën e përgatitur për hartimin e planeve të integritetit, mbështetur në kuadrin ligjor, rregullator dhe institucional mbi etikën, ndalimin e diskriminimit, parandalimin e konfliktit të interesit, deklarimin e pasurisë së zyrtarëve publikë, korrupsionin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve dhe të drejtën për informim në administratën publike. Pjesë e procesit janë edhe metodologjia e vlerësimit të riskut të integritetit dhe metodologjia për monitorimin dhe raportimin e planit të integritetit në administratën publike, dy akte të miratuara nga Ministri i Drejtësisë. Grupi i trajnerëve të administratës që do të ofrojnë ekspertizën e tyre në vijim janë zyrtarë të Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion në Ministrinë e Drejtësisë, përfaqësues nga institucionet e varësisë të kësaj ministrie, koordinatorë të integritetit në ministritë e linjës, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Komisioneri për të Drejtën për Informim dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

